



Biografi e shkurtër

Znj. Olivia Hoxha diplomohet “Jurist” në vitin 2004, në Fakultetin e Drejtësisë, dega Juridik, Shkoder.

Në vitin 2005 anëtarësohet në Dhomën e Avokatisë Shkodër pasi fiton titullin Avokat, profesion të cilin e ka ushtruar pa ndërprerje deri në fund të vitit 2017.

Gjatë karrierës në vitin 2008 bëhet anëtare e Kryesisë së Dhomës së Avokatisë Shkodër, për një mandat 4-vjecar. Në vitin 2016 zgjidhet anëtare e Këshillit Kombëtar të Avokatisë në Tiranë, dhe më pas në Bordin Drejtues të Dhomës Kombëtare.

Në vitin 2017 caktohet nga Dhoma e Avokatisë Tiranë si përfaqesuese e grupit të punës për Anti-Korrupsionin në Ballkan (BRRLN).

Ka kryer një sërë trajnimesh profesionale me vendas dhe të huaj, si dhe ka qënë aktiviste e të drejtave të njeriut pranë Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Zotëron gjuhën angleze dhe italiane, si dhe ka njohuri të gjuhës serbo-kroate.

Aktualisht, është pjesë e strukturës së Njesisë Ligjore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me detyrën Këshilltare Ligjore.